

Njoftim për përqendrim me të cilin GALENIKA SHA Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll të plotë mbi Sanofarm sh.p.k., Republika e Sllovenisë

(Lënda nr. 08-151 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më 22.10.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin GALENIKA SHA Beograd, me seli të regjistruar në rrugën Batajnički drum bb, Beograd – Zemun, Serbi, do të fitojë kontroll të plotë mbi Sanofarm sh.p.k., me seli të regjistruar në Industrijska 6r, 6310 Izola, Slloveni, përmes shitblerjes së pjesëve

-GALENIKA SHA Beograd është themeluar në vitin 1945, ndërsa që nga viti 2017 është pjesë e Grupit brazilian NK. Veprimtaria kryesore e GALENIKA SHA Beograd është prodhimi i preparateve farmaceutike, kryesisht ilaçe që lëshohen me recetë mjekësore. Një pjesë më e vogël e asortimentit të saj përfshin produkte që mund të lëshohen pa recetë mjekësore, si dhe produkte të caktuara të destinuara për përdorim në ordianca profesionale stomatologjike.

GALENIKA SHA Beograd ka përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht:

GALENIKA SHA Beograd, Serbi – PËRFAQËSIA SHKUP, me seli të regjistruar në bulevardin “Koço Racin” nr. 14, Shkup, me veprimtari parësore kërkime tregu dhe hulumtime të opinionit publik, si dhe Shoqëria e shërbimeve GALENIKA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në bulevardin “Koço Racin” nr. 14, Shkup – Qendër, me veprimtari parësore kërkime dhe zhvillim eksperimental në shkencat shoqërore dhe humane.

-Sanofarm sh.p.k. është kompani sllovene që merret me import dhe shpërndarje të preparateve natyrore – suplemente dietike nga prodhuesit italianë Pharmalife Research srl dhe ESI srl. Sanofarm sh.p.k. është importues dhe distributor ekskluziv i preparateve të këtyre prodhuesve për Slloveni dhe Kroaci.

Sanofarm sh.p.k. nuk ka shoqëri të varur, degë apo përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe nuk gjeneron të ardhura në territorin e saj.

Transaksioni i propozuar i referohet tregut të tregtisë me shumicë të produkteve farmaceutike që lëshohen pa recetë mjekësore (*produktet OTC*) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail në: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

24.10.2025

Shkup